

Para	SKK 3 “INSTRUMENTET FINANCIARE” - PËRDITËSUAR (2023)
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 3 <i>Instrumentet financiare</i> (SKK 3), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga ministri përgjegjës për financat, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm të instrumenteve financiare si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe raportimit, të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin për kontabilitetin.
2	SKK 3 është i krahasueshëm me Seksionin 11 <i>Instrumentet Financiare Bazë</i> dhe Seksionin 12 <i>Çështje të tjera për instrumentet financiare</i> të SNRF për NVM-të (2015). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të SNRF për NVM-të (2015) është dhënë në paragrafin 81. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 3 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike raportuese duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike, siç kërkohet në Ligjin për kontabilitetin.
3	Pasqyrat financiare do të përgatiten mbi bazën e konceptit të materialitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nuk do të zbatohen për zërat jomaterialë. Parimi i materialitetit përkufizohet dhe sqarohet në paragrafët –64 deri 68 të SKK 1.
	SEKSIONI 1 – INSTRUMENTET FINANCIARE BAZË
	FUSHA E ZBATIMIT
4	Seksioni 1 i këtij Standardi do të zbatohet për kontabilizimin e instrumenteve të mëposhtme financiare: (a) mjetet monetare. (b) një instrument borxhi (llogari, dëftesë ose hua e arkëtueshme ose e pagueshme) që plotëson kushtet në paragrafin 7. (c) një zotim për të marrë një hua e cila: (i) nuk mund të paguhet në para, dhe (ii) kur zotimi realizohet, pritet që ai të plotësojë kushtet e dhëna në paragrafin 7.
5	Shembuj të instrumenteve financiare që plotësojnë kushtet e paragrafit 4 më sipër përfshijnë: (a) mjetet monetare; (b) depozita pa afat dhe depozita me afat fiks ku njësia ekonomike është depozituesi (p.sh, llogaritë bankare); (c) letra tregtare dhe kambiale tregtare; (d) llogari, dëftesa dhe hua të arkëtueshme dhe të pagueshme; (e) obligacione dhe instrumente të ngjashme borxhi; (f) zotim për të marrë një hua nëse zotimi nuk mund të paguhet në mjete monetare.
6	Ky Standard nuk do të zbatohet për instrumentet e mëposhtme financiare: (a) investimet në filiale, pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta që janë kontabilizuar në përputhje me SKK 14 <i>Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta</i> ; (b) instrumente financiare që plotësojnë kriteret e kapitalit të vet të një njësie ekonomike; (c) qiratë, për të cilat zbatohet SKK 7 <i>Kontabilizimi i Qirave</i> ; Gjithsesi, kërkesat e çregjistrimit në paragrafët 33-35 zbatohen për çregjistrimin e qirave të arkëtueshme të njohura nga një qiradhënës dhe qirave të pagueshme të njohura nga një qiramarrës. (d) të drejtat dhe detyrimet e punonjësve sipas planeve të përfitimeve të punonjësve.
7	Një instrument borxhi që plotëson të gjitha kushtet e dhëna në (a)–(d) më poshtë duhet të kontabilizohet në përputhje me këtë Standard: (a) Përfitimet e mbajtësit janë në formën e: (i) një shume fikse; (ii) një norme fikse kthimi përgjatë jetës së instrumentit; (iii) një kthimi variabël që përgjatë jetës së instrumentit, është i barabartë me një normë interesi të vetme të kuotuar (si LIBOR). ose (b) Nuk ka asnjë kusht kontraktual që mund të sjellë humbjen për mbajtësin, të shumës së principalit ose të interesit të periudhës aktuale ose periudhave të mëparshme. Fakti që një instrument borxhi është i varur nga instrumente të tjerë borxhi nuk është një shembull i një kushti të tillë kontraktual;

	<p>(c) Kushtet kontraktuale që e lejojnë emetuesin (debitorin) të parapagujë një instrument borxhi ose që e lejojnë mbajtësin (kreditorin) t'ia shesë mbrapsht emetuesit atë përpara maturimit, nuk janë kushtëzuese nga ngjarje të ardhshme;</p> <p>(d) Nuk ka kthime të kushtëzuara ose kushte ripagese përveç normës variabël të kthimit të përshkruar në (a) dhe kushteve të parapagimit të përshkruara në (c).</p>
8	<p>Shembuj të instrumenteve financiare që normalisht i plotësojnë kushtet e dhëna në paragrafin 7 janë:</p> <p>(a) kërkesa tregtare të arkëtueshme dhe të pagueshme, dhe hua nga bankat ose palë të treta;</p> <p>(b) detyrime të pagueshme në një monedhë të huaj; (gjithsesi, çdo ndryshim në detyrimet e pagueshme për shkak të një ndryshimi në kursin e këmbimit njihet në fitim ose humbje siç kërkohet nga SKK 12 <i>Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit</i>)</p> <p>(c) hua të marra nga/për filialet ose pjesëmarrjet që janë të pagueshme kur kërkohen;</p> <p>(d) një instrument borxhi që bëhet menjëherë i arkëtueshëm nëse emetuesi nuk shlyen një pagesë interesi ose principali (një kriter i tillë nuk është në kundërshti me paragrafin 7).</p>
9	<p>Shembuj të instrumenteve financiare që nuk i plotësojnë kushtet e dhëna në paragrafin 7 dhe që rrjedhimisht janë jashtë fushës së zbatimit të këtij Standardi, jepen në vijim:</p> <p>(a) një investim në instrumentet e kapitalit të një njësie tjetër;</p> <p>(b) një kontratë shkëmbimi (SWAP) nga e cila përfitohet një fluks monetar që është pozitiv ose negativ, ose një zotim i ardhshëm për të blerë një mall apo një instrument financiar që mund të paguhet në para dhe që në momentin e pagesës, mund të rezultojë në flukse monetare pozitive ose negative (shih paragrafin 7.a);</p> <p>(c) opsionet dhe kontratat e ardhshme, pasi përfitimet për mbajtësin nuk janë fikse dhe kështu nuk plotësohet kushti i kërkuar në paragrafin 7.a);</p> <p>(d) investimet në instrumente borxhi të konvertueshme, pasi përfitimi për mbajtësin mund të variojë më tepër sipas çmimit të aksioneve të kapitalit të emetuesit sesa sipas normave të interesit në treg;</p> <p>(e) një hua e arkëtueshme nga një palë e tretë që i jep palës së tretë të drejtën ose detyrimin për të parapaguar nëse dispozitat fiskale ose kërkesat e kontabilitetit ndryshojnë, sepse një hua e tillë nuk plotëson kushtin e dhënë në paragrafin 7.c.</p>
	PËRKUFIZIMET KRYESORE
10	<p>Përkufizimet e mëposhtme përdoren në këtë Standard me kuptimet e specifikuar më poshtë:</p> <p><u>Instrument financiar</u> është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar për një njësi ekonomike si dhe një detyrim financiar ose instrument kapitali për një njësi ekonomike tjetër.</p> <p><u>Instrument kapitali</u> është çdo kontratë që evidenton një interes të mbetur në aktivet neto të njësisë ekonomike të investuar (për shembull një aksion).</p> <p><u>Aktivi financiar</u> është çdo aktiv që është:</p> <p>(a) mjete monetare;</p> <p>(b) një e drejtë kontraktuale për të marrë mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar nga një njësi ekonomike tjetër (për shembull, kërkesat për t'u arkëtuar);</p> <p><u>Detyrimi financiar</u> është detyrimi kontraktual për të dhënë mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar të një njësi ekonomike tjetër (për shembull detyrimi ndaj një furnitori).</p> <p><u>Kostoja</u> është:</p> <p>(a) vlera e drejtë e mjeteve monetare ose e ekuivalenteve të saj të paguara ose vlera e drejtë e shpërblimeve të dhëna për të blerë një aktiv në kohën e blerjes ose të ndërtimit të tij;</p> <p>(b) shuma e mjeteve monetare ose e ekuivalenteve të saj të arkëtuara ose vlera e drejtë e shpërblimeve të marra për të shitur një detyrim në kohën e shitjes ose likuidimit të tij.</p> <p><u>Kosto e amortizuar</u> është kosto fillestare e një aktivi ose detyrimi financiar e cila rregullohet, nëse është e nevojshme, me shumën e mëposhtme:</p> <p>(a) shlyerjet e principalit (për shembull, në rastin e një huaje të marrë apo të dhënë);</p> <p>(b) amortizimi i akumuluar i ndonjë difference mes shumës fillestare dhe shumës në maturim (për shembull në rastin e obligacioneve) duke përdorur metodën e interesit efektiv;</p> <p>(c) zvogëlimi i mundshëm për shkak të përkeqësimit ose të pamundësisë së arkëtimit (në rastin e aktiveve financiare të paarkëtueshme).</p>

	<p><u>Metoda e normës së interesit efektiv</u> është një metodë për llogaritjen e kostos së amortizuar të një aktivi apo detyrimi financiar, duke përdorur normën e interesit efektiv.</p> <p><u>Norma e interesit efektiv</u> është norma me të cilën skontoohen ekzaktësisht flukset e përlllogaritura të ardhshme të parasë së një aktivi ose të një detyrimi financiar, në vlerën kontabël të aktivit, ose detyrimin financiar. Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha kostot e transaksioneve, të paguara ose të marra, në lidhje me aktivin ose detyrimin financiar, si dhe të gjitha primet dhe zbritjet e tjera.</p> <p><u>Kostot e transaksioneve</u> janë kosto shtesë, të cilat lidhen me blerjen, emetimin ose likuidimin e një aktivi ose detyrimi financiar. Kostot shtesë janë kosto të tilla, të cilat nuk ndodhin nëse nuk kryhet blerja, emetimi ose likuidimi.</p>
	NJOHJA DHE MATJA E INSTRUMENTEVE FINANCIARE BAZË
	Njohja e aktiveve dhe detyrimeve financiare
11	Një njësi duhet të njohë një aktiv financiar ose një detyrim financiar vetëm kur njësi bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit.
	Matja fillestare
12	Kur një aktiv financiar ose një detyrim financiar njihet fillimisht, një njësi duhet ta masë atë me kostot e transaksionit (duke përfshirë edhe çmimin e transaksionit) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb një transaksion financiar. Një transaksion financiar mund të jetë, për shembull, kur shiten mallra apo shërbime dhe kur pagesa shtyhet përtej afateve normale të tregtisë ose kur ajo është financuar me një normë interesi që nuk është një normë tregu. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, njësi duhet të matë aktivin financiar ose detyrimin financiar me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.
13	<p>Shembuj të matjes së aktiveve financiare jepen në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Për një hua afatgjatë dhënë një njësi tjetër, njihet një shumë e arkëtueshme me vlerën aktuale të mjeteve monetare të arkëtueshme (duke përfshirë pagesat e interesit dhe principalit) nga ajo njësi. 2. Për mallrat, produktet dhe shërbimet e shitura një klienti me një kredi afatshkurtër, njihet një llogari e arkëtueshme me vlerën e paskontuar të mjeteve monetare të arkëtueshme nga ajo njësi, që është normalisht çmimi i faturës. 3. Për një produkt të shitur një klienti me një kredi dyvjeçare pa interes, njihet një llogari e arkëtueshme me çmimin aktual të shitjes për atë produkt. Nëse çmimi normal i shitjes nuk dihet, ai mund të vlerësohet si vlera aktuale e mjeteve monetare të arkëtueshme të skontuar duke përdorur normën mbizotëruese të interesit në treg për një kërkesë të arkëtueshme të ngjashme. 4. Për një blerje në para të aksioneve të zakonshme të një njësi tjetër, investimi duhet të njihet me shumën e mjeteve monetare të paguara për të blerë aksionet.
14	<p>Shembuj të matjes së detyrimeve financiare jepen në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Për një hua të marrë nga një bankë, njihet një llogari e pagueshme fillimisht me vlerën aktuale të mjeteve monetare të pagueshme ndaj bankës (psh duke përfshirë pagesat e interesit dhe të principalit). 2. Për mallrat, produktet e shërbimet e blera nga një furnizues me kredi afatshkurtër, njihet një llogari e pagueshme me shumën e paskontuar që i detyrohet furnizuesit, që është zakonisht çmimi i faturës.
	Vlerësimi i mëpasshëm
15	<p>Në fund të periudhës raportuese, një njësi duhet të masë instrumentet financiare si vijon (pa zbritur kostot e transaksionit që njësi mund të kryejë mbi shitjet apo të tjera):</p> <p>(a) Instrumentet e borxhit që plotësojnë kushtet në paragrafin 4(b) duhet të maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Paragrafët 16-21 japin udhëzime për përcaktimin e kostos së amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Instrumentet e borxhit që janë të klasifikuara si aktive afatshkurtër ose detyrime afatshkurtër duhet të maten me shumën e paskontuar të mjeteve monetare ose shumave të tjera të pritshme për t'u paguar ose arkëtuar (shih paragrafët 22-27) përveçse kur marrëveshja përbën në efekt, një transaksion financiar (shih paragrafin 12). Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, njësi duhet ta masë instrumentin e borxhit me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me një normë tregu interesi për një instrument të ngjashëm borxhi.</p> <p>(b) Zotimet për të marrë një hua që plotësojnë kushtet e dhëna në paragrafin 4(c) duhet të matet me kosto (që ndonjëherë është zero) minus zhvlerësimin. Zhvlerësimi ose pambledhshmëria duhet të vlerësohet për instrumentet financiarë të përshkruara në (a) dhe (b) më sipër. Paragrafët 22-27 japin udhëzime në lidhje me këtë aspekt.</p>

	Kosto e amortizuar dhe metoda e interesit efektiv
16	Kosto e amortizuar e një aktivi financiar ose detyrimi financiar në çdo datë raportimi është shuma e vlerave të mëposhtme: (a) vlera me të cilën aktivi financiar ose detyrimi financiar janë matur në njohjen e tyre fillestare; (b) minus çdo pagesë të principalit; (c) plus ose minus amortizimin e akumuluar, duke përdorur metodën e interesit efektiv, të diferencës mes vlerës në njohje dhe vlerës në maturim; (d) minus, në rastin e një aktivi financiar, çdo pakësim (direkt ose përmes përdorimit të llogarisë së zhvlerësimit) për zhvlerësimin ose pambledhshmërinë. Aktivet financiare dhe detyrimet financiare që nuk kanë një normë interesi të deklaruar dhe janë të klasifikuara si aktive afatshkurtra ose detyrime afatshkurtra, maten fillimisht me shumën e paskontuar në përputhje me paragrafin 15(a). Në këto raste pika (c) më sipër nuk zbatohet.
17	Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së koston të amortizuar të një aktivi financiar ose një detyrimi financiar (ose një grup aktivesh ose detyrimesh financiare) dhe e shpërndarjes së të ardhurave të interesit ose shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma që i skonton ekzaktësisht pagesat ose arkëtimet e ardhshme përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar, ose, kur është e përshtatshme, përgjatë një periudhe më të shkurtër, tek vlera kontabël e aktivit financiar ose detyrimit financiar. Norma e interesit efektiv përcaktohet mbi bazën e vlerës kontabël të aktivit financiar ose detyrimit financiar në momentin e njohjes. Sipas metodës së interesit efektiv: (a) kosto e amortizuar e një aktivi (detyrimi) financiar është vlera aktuale e arkëtimeve (pagesave) të ardhshme të skontuara me normën e interesit efektiv; dhe (b) shpenzimet (të ardhurat) e interesit në një periudhë të caktuar janë baraz me vlerën kontabël të detyrimit (aktivit) financiar në fillim të periudhës shumëzuar me normën e interesit efektiv për periudhën).
18	Kur llogarit normën e interesit efektiv, një njësi duhet të parashikojë flukset e mjeteve monetare duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar (p.sh., parapagimi) dhe humbjet e njohura financiare që kanë ndodhur, por ajo nuk duhet të marrë parasysh humbje të ardhshme të mundshme financiare që nuk kanë ndodhur ende.
19	Kur llogarit normën e interesit efektiv, një njësi duhet të amortizojë çdo tarifë të mundshme, detyrime financiare të paguara ose të arkëtuara (si psh pikët ‘bonus’), kostot e transaksionit dhe prime ose skonto të tjera gjatë jetës së pritshme të instrumentit, përveç si vijon. Njësia duhet të përdorë një periudhë më të shkurtër nëse kjo është periudha me të cilën lidhen tarifat, detyrimet financiare të paguara ose të arkëtuara, kostot e transaksionit, primet ose skontot. Ky do të jetë rasti kur komponentit variabël me të cilin lidhen tarifat, detyrimet financiare të paguara ose të arkëtuara, kostot e transaksionit, primet ose skontot rriçmohen me normat e tregut përpara maturimit të pritshëm të instrumentit. Në një rast të tillë, periudha e përshtatshme e amortizimit është periudha deri në datën e rriçmimit tjetër.
20	Për aktive financiare dhe detyrime financiare me normë variabël, rivlerësimi periodik i flukseve të mjeteve monetare me qëllim që të reflektohen ndryshimet në normat e interesit të tregut, ndryshon normën e interesit efektiv. Nëse një aktiv apo detyrim financiar me normë variabël njihet fillimisht me një vlerë të barabartë me principalin e arkëtueshëm ose të pagueshëm në maturim, rivlerësimi i pagesave të ardhshme të interesit nuk ka ndonjë efekt domethënës në vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit.
21	Nëse një njësi ekonomike rishikon vlerësimet e saj të pagesave ose arkëtimeve, ajo duhet të rregullojë vlerën kontabël të aktivit financiar ose detyrimit financiar (ose një grup instrumentash financiarë) për të reflektuar flukset e mjeteve monetare aktuale dhe të rishikuara. Njësia duhet të rillogarisë vlerën kontabël duke llogaritur vlerën aktuale të flukseve të ardhshme të rishikuara të mjeteve monetare me normën fillestare të interesit efektiv të instrumentit financiar. Njësia duhet të njohë efektin si të ardhur ose shpenzim në fitim ose humbje në datën e rishikimit.
	ZHVLERËSIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE TË MATUR ME KOSTO OSE KOSTON E AMORTIZUAR
	Njohja
22	Në fund të çdo periudhe raportimi, një njësi duhet të vlerësojë nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njësia duhet të njohë menjëherë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.
23	Evidenca objektive që një aktiv financiar ose një grup aktivesh financiare janë zhvlerësuar përfshin ngjarjet e mëposhtme të cilat vijnë në vëmendjen e mbajtësit të aktivit: (a) vështirësi financiare domethënëse të emetuesit ose detyruesit ; (b) një shkelje kontrate, si mospagesë ose pamundësi pagese të interesit ose principalit ;

	<p>(c) kreditori, për arsye ekonomike ose ligjore që lidhen me vështirësinë financiare të debitorit, i ofron këtij të fundit konçesione që kreditori nuk do t'i ofronte në kushte të tjera ;</p> <p>(d) është bërë e mundshme që debitori do të kalojë në falimentim ose riorganizime të tjera financiare ;</p> <p>(e) të dhënat tregojnë që ka patur një rënie të matshme në flukset e ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare nga një grup aktivesh financiare që nga njohja e tyre, edhe pse rënia nuk mund të lidhet me një aktiv financiar të caktuar brenda grupit, të tilla si kushte ekonomike të dëmshme kombëtare ose vendore ose ndryshime të dëmshme në industri.</p>
24	Faktorë të tjerë mundet gjithashtu të jenë evidencë e zhvlerësimit, përfshirë ndryshime domethënëse me një efekt të dëmshëm që kanë ndodhur në mjediset teknologjike, të tregut, ekonomike apo ligjore në të cilat vepron emetuesi.
25	<p>Për qëllimin e zhvlerësimit, një njësi ekonomike duhet të vlerësojë individualisht aktivet e mëposhtme financiare:</p> <p>(a) të gjithë instrumentet e kapitalit të investuara, pavarësisht rëndësisë; dhe</p> <p>(b) të gjithë aktivet e tjera financiare që janë individualisht domethënëse.</p> <p>Një njësi ekonomike duhet të vlerësojë për zhvlerësim aktivet e tjera financiare ose individualisht ose të grupuara në bazë të karakteristikave të ngjashme të riskut.</p>
	Matja
26	<p>Një njësi duhet të masë një humbje nga zhvlerësimi për instrumentet e mëposhtëm të matur me kosto ose kosto të amortizuar si vijon:</p> <p>(a) për një instrument të matur me koston e amortizuar në përputhje me paragrafin 15(a), humbja nga zhvlerësimi është diferenca mes vlerës kontabël të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve të vlerësuara monetare të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv. Nëse një instrument i tillë ka një normë variabël interesi, norma e skontimit për matjen e çdo humbje nga zhvlerësimi është norma e interesit efektiv aktual të përcaktuar sipas kontratës;</p> <p>(b) për një instrument të matur me kosto minus zhvlerësim në përputhje me paragrafin 15(b), humbja nga zhvlerësimi është diferenca mes vlerës kontabël të aktivit dhe vlerësimit më të mirë (që është një përafrim) që njësia mund të marrë për aktivin nëse ai do të shitej në datën e raportimit.</p>
	Rimarrja
27	Nëse, në një periudhë pasuese, shuma e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi ishte njohur zhvlerësimi (si një përmirësim në vlerësimin e pozicionit financiar të debitorit), njësia ekonomike duhet të rimarrë humbjen nga zhvlerësimi të njohur më parë ose direkt ose duke rregulluar një llogari zhvlerësimi. Rimarrja nuk duhet të rezultojë në një vlerë kontabël të aktivit financiar (netuar me ndonjë llogari zhvlerësimi) që tejkalon vlerën kontabël që do të kishte qenë nëse nuk do të njihet humbja nga zhvlerësimi. Njësia duhet të njohë menjëherë shumën e rimarrjes në fitim ose humbje.
	ÇREGJISTRIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE BAZË
	Çregjistrimi i aktiveve financiare
28	<p>Një njësi duhet të çregjistrojë një aktiv financiar vetëm kur:</p> <p>(a) të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare nga aktivi financiar skadojnë ose shlyhen; ose</p> <p>(b) njësia i transferon një palë tjetër pothuajse të gjitha risqet dhe përfitimet nga zotërimi i aktivit financiar; ose</p> <p>(c) njësia, pavarësisht se ka mbajtur disa risqe dhe përfitime domethënëse të zotërimit, ka transferuar kontrollin e aktivit tek një palë tjetër dhe pala tjetër ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësinë e tij një palë të tretë të palidhur dhe është në gjendje të ushtrojë këtë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa pasur nevojë të imponojë kufizime shtesë në lidhje me këtë transferim. Në këtë rast njësia duhet:</p> <p>(i) të çregjistrojë aktivin; dhe</p> <p>(ii) të njohë në mënyrë të ndarë çdo të drejtë të mbajtur apo detyrim krijuar në transfertë.</p> <p>Vlera kontabël e aktivit të transferuar duhet të shpërndahet mes të drejtave ose detyrimeve të mbajtura dhe atyre të transferuara mbi bazën e vlerave të tyre të drejta në datën e transferimit. Të drejtat dhe detyrimet e reja të krijuara në këtë transferim duhet të maten me vlerën e tyre të drejtë në datën e transferimit. Çdo diferencë mes shumës së marrë dhe shumave të njohura dhe të çregjistruara në përputhje me këtë paragraf duhet të njihet në fitim ose humbje në periudhën kur ka ndodhur transferimi.</p>

29	Nëse një transferim nuk rezulton në çregjistrim për shkak se njësia ka mbajtur risqe dhe përfitime domethënëse të zotërimit të aktivit të transferuar, njësia duhet të vazhdojë të njohë aktivin e transferuar në tërësinë e tij dhe duhet të njohë një detyrim financiar për shumën e marrë. Aktivi dhe detyrimi nuk duhet të kompensohen. Në periudhat pasuese, njësia duhet të njohë çdo të ardhur mbi aktivin e transferuar dhe çdo shpenzim të kryer mbi detyrimin financiar.
30	Nëse transferuesi i siguron të transferuarit kolateral jo në mjete monetare (si instrumente të borxhit ose të kapitalit), kontabilizimi i kolateralit nga transferuesi dhe i transferuari varet nga fakti nëse i transferuari ka të drejtën të shesë ose të rikolateralizojë kolateralin dhe nëse transferuesi ka dështuar në pagesa. Transferuesi dhe i transferuari duhet të kontabilizojnë kolateralin si vijon: (a) Nëse i transferuari ka të drejtën sipas kontratës ose praktikës të shesë ose të rikolateralizojë kolateralin, transferuesi duhet ta riklasifikojë atë aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar (psh si një aktiv i dhënë hua, instrumente kapitali të lëna si kolateral, ose të arkëtueshme të riblera) veçmas nga aktivet e tjera; (b) Nëse i transferuari shet kolateralin e vendosur tek ai, ai duhet të njohë shumat e marra nga shitja, si dhe një detyrim të matur me vlerën e drejtë për detyrimin e tij për të rikthyer kolateralin; (c) Nëse transferuesi nuk paguan sipas kushteve të kontratës dhe nuk ka më të drejtën për të rimarrë kolateralin, ai duhet ta çregjistrojë kolateralin dhe i transferuari duhet të njohë kolateralin si aktiv të tij fillimisht të matur me vlerën e drejtë, ose nëse ai e ka shitur tashmë kolateralin, të çregjistrojë detyrimin e tij për të rikthyer kolateralin; (d) Përveç siç kërkohet në (c) më sipër, transferuesi duhet të vazhdojë të mbajë kolateralin si aktivin e tij dhe i transferuari nuk duhet të njohë kolateralin si një aktiv.
	Faktoringu i kërkesave për t'u arkëtuar dhe veprimet e riblerjes
31	Një kontratë faktoringu është shitja e kërkesave për t'u arkëtuar, ku në varësi të llojit të kontratës blerësi ka të drejtë t'i rishesë kërkesat e arkëtueshme të transferuara brenda një kohe të caktuar (faktoringu me kthim) ose nuk ka asnjë të drejtë për rishitje, dhe të gjitha rreziqet ose të mirat që lidhen me zotërimin e një kërkesë për arkëtim kalojnë nga shitësi te blerësi (faktoringu pa kthim).
32	Nëse "shitësi" mban detyrimin e riblerjes, transaksioni do të njihet si një transaksion financiar (d.m.th. si një hua, garancia e së cilës është kërkesa për t'u arkëtuar), dhe jo si shitje. Një kërkesë për t'u arkëtuar nuk konsiderohet si e shitur, si rezultat i faktoringut, por ajo qëndron në pasqyrën e pozicionit financiar deri sa kërkesa për t'u arkëtuar të mblidhet, ose e drejta e kthimit ka skaduar. Nëse nuk ka ndonjë të drejtë riblerjeje, dhe kontrolli mbi kërkesën për t'u arkëtuar dhe rreziqet e të mirat që lidhen me të i janë kaluar blerësit, veprimi do të njihet si kërkesë për t'u arkëtuar.
	Çregjistrimi i detyrimeve financiare
33	Një njësi duhet të çregjistrojë një detyrim financiar (ose një pjesë të detyrimit financiar) vetëm kur ai shuhet, p.sh., kur detyrimi i specifikuar në kontratë shlyhet, anulohet ose skadon.
34	Nëse një huadhënës dhe huamarrës ekzistues shkëmbejnë instrumente financiare me kushte thelbësisht të ndryshme, njësitë duhet ta kontabilizojnë transaksionin si një shuarje të detyrimit fillestar financiar dhe njohjen e një detyrimi të ri financiar. Në mënyrë të ngjashme, një njësi duhet të kontabilizojë një modifikim thelbësor të kushteve të një detyrimi financiar ekzistues ose një pjesë të tij (pavarësisht nëse ky modifikim vjen ose jo si pasojë e vështirësive financiare të debitorit) si një shuarje e detyrimit financiar fillestar dhe njohjen e një detyrimi të ri financiar.
35	Një njësi duhet të njohë në fitim ose humbje çdo diferencë mes vlerës kontabël të detyrimit financiar (ose pjesës së një detyrimi financiar) të shuar ose të transferuar tek një palë e tretë dhe shumën e paguar, duke përfshirë çdo aktiv jomonetar të transferuar ose detyrime të marra përsipër.
	SHËNIMET SHPJEGUESE PËR INSTRUMENTET FINANCIARE BAZË
36	Një njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese tek përmbledhja e politikave më të rëndësishme kontabël, bazën (ose bazat) e matjes të përdorur për instrumentet financiare, si dhe politikat e tjera kontabël të përdorura për instrumentet financiare që janë të rëndësishëm për kuptueshmërinë e pasqyrave financiare.
37	Një njësi ekonomike duhet të japë informacion për vlerën kontabël të secilit prej kategorive vijuese të aktiveve dhe detyrimeve financiare (në total) në datën e raportimit, ose në pasqyrën e pozicionit financiar, ose në shënimet shpjeguese: (a) aktivet financiare që janë instrumente borxhi të matura me koston e amortizuar (paragrafi 15.a); (b) detyrime financiare të matura me koston e amortizuar (paragrafi 15.a); (f) zotime huaje të matura me kosto minus zhvlerësim (paragrafi 15.b).

38	Një njësi duhet të japë informacion shpjegues që i jep mundësi përdoruesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë rëndësinë që kanë instrumentet financiare në pozicionin dhe performancën e vetë njësisë. Për shembull, informacioni për huanë afatgjatë normalisht do të përfshinte afatet dhe kushtet e instrumentit të borxhit (si norma e interesit, maturimi, grafiku i ripagimit dhe kufizimet që instrumenti i borxhit i imponon njësisë).
	<i>Çregjistrimi</i>
39	Nëse një njësi i ka transferuar aktivet financiare një pale të tretë në një transaksion që nuk kualifikohet për çregjistrim (shiko paragrafët 28–30), njësia duhet të japë informacion shpjegues për secilën nga klasat vijuese të aktiveve financiare: (a) natyrën e aktiveve; (b) natyrën e risqeve dhe përfitimeve nga zotërimi ndaj të cilave njësia mbetet e ekspozuar; (c) vlerat kontabël të aktiveve dhe të çdo detyrimi përkatës, që njësia vazhdon t'i njohë.
	<i>Kolaterali</i>
40	Kur një njësi ka vendosur aktive financiare si kolateral për detyrimet ekzistuese ose detyrimet e kushtëzuara, ajo duhet të japë informacion shpjegues si më poshtë: (a) vlerën kontabël të aktiveve financiare të vendosura si kolateral; (b) afatet dhe kushtet e kolateralit.
	<i>Mospagesat dhe shkeljet në huatë e pagueshme</i>
41	Për huatë e pagueshme të njohura në datën e raportimit për të cilat ka pasur shkelje të afateve ose mospagim të principalit, interesit, apo shkelje të kushteve të shlyerjes që nuk janë korrigjuar në datën e raportimit, një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues si vijon: (a) detajet e kësaj shkelje ose mospagese; (b) vlerën kontabël të huave të pagueshme në datën e raportimit; (c) nëse shkelja ose mospagesa është korrigjuar, ose nëse afatet e huasë së pagueshme janë rinegociuar, përpara se pasqyrat financiare të aprovoheshin për publikim.
	<i>Zëra të të ardhurave, shpenzimeve, fitimeve ose humbjeve</i>
42	Një njësi duhet të japë informacion shpjegues për zërat vijues të të ardhurave, shpenzimeve, fitimeve ose humbjeve: (a) të ardhurat, shpenzimet, fitimet ose humbjet, nga: (i) aktivet financiare të matura me koston e amortizuar; (ii) detyrimet financiare të matura me koston e amortizuar; (b) të ardhurat totale nga interesi dhe shpenzimet totale nga interesi (të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv) ; (c) shumën e çdo humbjeje nga zhvlerësimi për çdo klasë të aktiveve financiare.
	SEKSIONI 2 - ÇËSHTJE TË TJERA PËR INSTRUMENTET FINANCIARE
	FUSHA E ZBATIMIT
43	Seksioni 2 zbatohet për instrumentet dhe transaksionet financiare të tjera më të ndërlikuara. Nëse një njësi ekonomike hyn në transaksione vetëm të instrumenteve financiare bazë të seksionit 1 atëherë seksioni 2 nuk është i zbatueshëm. Megjithatë, edhe njësitë ekonomike që përdorin vetëm instrumentet financiare bazë do të kenë parasysh objektin e seksionit 2 për t'u siguruar se ato janë të përjashtuar.
44	Seksioni 2 i këtij Standardi do të zbatohet edhe për investimet në aksione të preferuara të pakonvertueshëm dhe të pashitshëm dhe aksione të zakonshme të pashitshëm, që tregtohen publikisht ose vlera e drejtë e të cilëve, në të kundërt mund të matet në mënyrë të besueshme.
45	Seksioni 2 i këtij Standardi do të zbatohet për të gjitha instrumentet financiare, përveç sa më poshtë: (a) atyre që mbulohen nga seksioni 1; (b) interesave në filiale (shih SKK 9), interesat në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta (shih SKK 14); (c) të drejtat sipas kontratave të sigurimit përveç kontratës së sigurimit që mund të rezultojë në një humbje të të dyja palëve si rezultat i kushteve kontraktuale që nuk kanë lidhje me: (i) ndryshimet në rrezikun e siguruar; (ii) ndryshimet në kursin e këmbimit të monedhave të huaja; ose me (iii) një mosplotësim të detyrimit nga njëra prej palëve.

	<p>(e) instrumentet financiare që plotësojnë përkufizimin e 'kapitalit të vet' të njësisë ekonomike;</p> <p>(f) qiratë (shih SKK 7 <i>Qiratë</i>) përveç rastit kur qiraja mund të rezultojë në një humbje të qiradhënësit ose qiramarrësit si rezultat i kushteve kontraktuale që nuk kanë lidhje me:</p> <p>(i) ndryshimet në çmimin e aktivit të dhënë me qira;</p> <p>(ii) ndryshimet në kurset e këmbimit të monedhave të huaja; ose me</p> <p>(iii) një mosplotësim të detyrimit nga njëra prej palëve.</p> <p>(g) kontratat për shuma të kushtëzuara në një kombinim biznesi (shih SKK 9). Ky përjashtim vlen vetëm për blerësin.</p>
46	Shumica e kontratave për të blerë ose shitur një element jo-financiar të tillë si një mall, inventar, ose aktive afatgjata materiale, janë të përjashtuara nga ky seksion, sepse këta elementë nuk janë instrumente financiare. Megjithatë, ky seksion zbatohet për të gjitha kontratat që i kalojnë rreziqet mbi blerësit apo shitësit, të cilat nuk janë tipike të kontratave për të blerë ose shitur aktive materiale. Për shembull, ky seksion zbatohet për kontratat që mund të rezultojnë në një humbje të blerësit ose shitësit si rezultat i kushteve kontraktuale që nuk kanë lidhje me ndryshimet në çmimin e elementit jofinanciar, ndryshimet në kursin e këmbimit të monedhave të huaja, ose me një mosplotësim të detyrimit nga njëra palë.
47	Përveç kontratave të përshkruara në paragrafin 46, ky seksion zbatohet për kontratat e blerjes apo shitjes të elementeve (zërave) jo-financiare, nëse kontrata mund të shlyhet neto në para ose në një instrument financiar tjetër, ose me shkëmbimin e instrumenteve financiare sikur kontratat të ishin instrumente financiare, me përjashtim të: kontratave, që lidhen dhe vazhdojnë të mbahen për qëllime të marrjes ose ofrimit të një zëri jo-financiar në përputhje me blerjen e pritshme, shitjen apo kërkesat e përdorimit që ka njësia ekonomike, të cilat nuk janë instrumente financiare për qëllime të këtij seksioni.
	NJOHJA DHE MATJA
	Njohja
48	Një njësi ekonomike duhet të njohë një aktiv financiar ose një detyrim financiar vetëm kur njësia ekonomike bëhet palë në kushtet kontraktuese të instrumentit.
	Matja
49	Një njësi ekonomike, kur njej një aktiv ose detyrim financiar sipas seksionit 2, duhet ta matë atë me vlerën e drejtë, e cila është zakonisht çmimi i transaksionit.
	Vlerësimi i mëpasshëm
50	Në fund të çdo periudhe raportimi, një njësi ekonomike duhet të matë të gjitha instrumentet financiare që janë objekt i seksionit 2 me vlerën e drejtë dhe të njohë ndryshimet në vlerën e drejtë në fitim ose humbje, përveç:
	- instrumenteve të kapitalit që nuk tregtohen publikisht dhe vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet ndryshe në mënyrë të besueshme, si dhe
	- kontratave të lidhura me instrumente të tillë që, nëse ushtrohen, do të rezultojnë në dhënien e këtyre instrumenteve, të cilat do të maten me koston pakësuar me shumën e zhvlerësimit.
51	Nëse një matje e besueshme e vlerës së drejtë nuk është më e disponueshme për një instrument kapitali që nuk tregtohet publikisht, por matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, vlera e drejtë në datën e fundit që instrumenti ka qenë i matshëm në mënyrë të besueshme, trajtohet si kosto e instrumentit. Njësi ekonomike do të vlerësojë këtë instrument me shumën e koston së tij pakësuar me zhvlerësimin deri sa një matje e besueshme e vlerës së drejtë të jetë e disponueshme.
52	Një investim në aksione të zakonshme ose të preferuara matet me vlerën e drejtë nëse vlera e drejtë e aksioneve mund të matet në mënyrë të besueshme. Një njësi duhet të përdorë hierarkinë vijuese për të vlerësuar vlerën e drejtë të aksioneve:
	(a) Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë është çmimi i kuotuar për një aktiv të ngjashëm në një treg aktiv. Ky është zakonisht çmimi aktual i ofertës;
	(b) Kur çmimet e kuotuar janë të padisponueshme, çmimi i një transaksioni të kohëve të fundit për një aktiv të ngjashëm siguron evidencë për vlerën e drejtë, për sa kohë nuk ka pasur ndonjë ndryshim domethënës në rrethanat ekonomike ose një kalim domethënës i kohës që kur ka ndodhur transaksioni. Nëse njësi mund të tregojë që çmimi i transaksionit të fundit nuk është një vlerësim i mirë i vlerës së drejtë (psh sepse ai reflekton vlerën që një njësi do të merrte ose paguante në një transaksion të detyruar, likuidim jo vullnetar ose shitje në gjendje të vështirë), ky çmim rregullohet.
	(c) Nëse tregu për aktivin nuk është aktiv dhe transaksionet e kohëve të fundit për llogari të tyre për një aktiv të ngjashëm nuk janë një vlerësim i mirë i vlerës së drejtë, një njësi vlerëson vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Objektivi i përdorimit të një teknike vlerësimi është për të vlerësuar çfarë çmimi do të kishte qenë në datën e matjes në një shkëmbim me vullnet të lirë të motivuar nga konsideratat normale të biznesit.

	Udhëzimet për teknikat e vlerësimit të vlerës së drejtë jepen në paragrafët 53-60.
	Vlera e drejtë - Teknikat e vlerësimit
53	Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin, nëse është e disponueshme, të referencave të transaksioneve me vullnet të lirë të kohëve të fundit për një aktiv të ngjashëm mes palëve në dijeni, me vullnet të lirë, për vlerën e drejtë të një aktivi tjetër që është në thelb i njëjtë si aktivi që po matet, me analizat e flukseve të mjeteve monetare dhe modeleve të vlerësimit të opsioneve. Nëse ka një teknikë vlerësimi gjerësisht të përdorur nga pjesëmarrësit e tregut për t'i vendosur një çmim aktiviteti dhe kjo metodë ka treguar që siguron vlerësime të besueshme të çmimeve të përfuara në transaksionet aktuale të tregut, njësia përdor atë teknikë.
54	Objekti i përdorimit të një teknike vlerësimi është të vendoset çfarë çmimi do të kishte qenë në datën e matjes në një transaksion të kryer në mënyrë të vullnetshme mes palëve të palidhura me njëra-tjetrën, të motivuara nga shumatat normale të biznesit. Vlera e drejtë vlerësohet në bazë të rezultateve të një teknike vlerësimi që përdor maksimumin e inputeve të tregut dhe mbështetet sa më pak të jetë e mundur inputet e vendosura në njësi. Një teknikë vlerësimi pritet të arrijë një vlerësim të besueshëm të vlerës së drejtë nëse: (a) ajo paraqet në mënyrë të arsyeshme sesi tregu pritet t'i caktojë një çmim aktiviteti dhe, (b) inputet për vlerësimin teknik përfaqësojnë në mënyrë të arsyeshme pritshmërinë dhe matjet e faktorëve të riskut të kthimit thelbësorë në aktiv.
	Treg jo-aktiv: instrumentet e kapitalit
55	Vlera e drejtë e investimeve në aktive që nuk kanë një çmim tregu të kuotuar, në një treg aktiv, është i matshëm në mënyrë të besueshme nëse: (a) ndryshueshmëria në shtrirjen e vlerësimit të arsyeshëm të vlerës së drejtë nuk është domethënëse për atë aktiv, ose (b) probabilitetet e vlerësimeve të ndryshme brenda shtrirjes mund të maten në mënyrë të arsyeshme dhe të përdoren në vlerësimin e vlerës së drejtë.
56	Ka shumë situata në të cilat ndryshueshmëria në shtrirjen e vlerësimeve të arsyeshme të vlerës së drejtë të aktiveve, që nuk kanë një çmim tregu të kuotuar, është e mundshme të mos jetë domethënëse. Normalisht është e mundur të vlerësohet vlera e drejtë e një aktivi që një njësi ekonomike ka blerë nga një palë e jashtme. Gjithsesi, nëse shtrirja e vlerësimit të arsyeshëm të vlerës së drejtë është domethënëse dhe probabilitetet e vlerësimeve të ndryshme nuk janë të matshme në mënyrë të arsyeshme, njësia përjashtohet nga matja e aktivitetit në vlerën e drejtë.
57	Nëse një matje e besueshme e vlerës së drejtë nuk është më e disponueshme për një aktiv të matur në vlerën e drejtë (psh një instrument kapitali i matur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes), vlera e tij kontabël në datën e fundit në të cilën aktivi ishte i matshëm në mënyrë të besueshme bëhet kosto e tij e re. Njësi duhet të masë aktivin me këtë kosto minus zhvlerësimin derisa bëhet e disponueshme një matje e besueshme e vlerës së drejtë.
58	Një njësi ekonomike duhet të zbatojë udhëzimet mbi vlerën e drejtë të dhëna në paragrafët 53-57 për matjen e vlerës së drejtë në përputhje me këtë seksion.
59	Vlera e drejtë e një detyrimi financiar që është i pagueshëm kundrejt kërkesës nuk duhet të jetë më e vogël se shuma e pagueshme kundrejt kërkesës, e skontuar që nga data e parë që shuma mund të kërkohet të paguhet.
60	Një njësi ekonomike nuk do të përfshijë shpenzimet e transaksionit në matjen fillestare të aktiveve dhe detyrimeve financiare që do të maten më vonë me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Nëse pagesa për një aktiv është shtyrë ose është financuar me një normë interesi që nuk është një normë e tregut, njësi ekonomike, fillimisht, do të matë aktivin me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuar me normën e tregut të interesit.
	ZHVLERËSIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE TË MATURA ME KOSTO OSE KOSTO TË AMORTIZUAR
61	Një njësi ekonomike duhet të zbatojë udhëzimet për zhvlerësimin e një instrumenti financiar të matur me kosto, të dhëna në paragrafët 22-27 për instrumentet financiare të matura me koston e pakësuar me zhvlerësimin në përputhje me këtë seksion.
	ÇREGJISTRIMI I NJË AKTIVI FINANCIAR OSE DETYRIMI FINANCIAR
62	Një njësi ekonomike duhet të zbatojë kërkesat e çregjistrimit të dhëna në paragrafët 28-30 dhe 33-35 për aktivet dhe detyrimet financiare për të cilat zbatohet ky seksion.
	KONTABILITETI MBROJTËS
63	Nëse plotësohen kriteret e specifikuar, një njësi ekonomike mund të caktojë një marrëdhënie mbrojtëse midis një instrumenti mbrojtës dhe një zëri të mbrojtur në mënyrë të tillë, që të kualifikohet për kontabilitetin mbrojtës. Kontabiliteti mbrojtës lejon që fitimi ose humbja në instrumentin mbrojtës dhe në zërin e mbrojtur, të njihet në fitim ose humbje në të njëjtën kohë.
64	Për t'u kualifikuar për kontabilitetin mbrojtës, një njësi ekonomike duhet të plotësojë të gjitha kushtet e mëposhtme: (a) njësi ekonomike përcakton dhe dokumenton marrëdhënien mbrojtëse në të cilën rreziku që duhet mbrojtur, zëri i mbrojtur dhe instrumenti mbrojtës, janë të

	<p>identifikuar qartazi dhe rreziku në zërin e mbrojtur është rreziku që mbrohet me instrumentin mbrojtës.</p> <p>(b) rreziku i mbrojtur është një nga rreziqet e specifikuar në paragrafin 65.</p> <p>(c) instrumenti mbrojtës është specifikuar në paragrafin 67.</p> <p>(d) njësia ekonomike pret që instrumenti mbrojtës të jetë tepër efektiv në kompensimin e rrezikut të caktuar i mbrojtur. Efektiviteti i një mbrojtjeje është shkalla në të cilën ndryshimet në vlerën e drejtë ose rrjedhën e parave të zërit të mbrojtur që i atribuohen rrezikut të mbrojtur kompensohen nga ndryshimet në vlerën e drejtë ose rrjedhën e parave të instrumentit mbrojtës.</p>
65	<p>Ky seksion lejon kontabilitetin mbrojtës vetëm për rreziqet e mëposhtme:</p> <p>(a) rrezikun e normës së interesit të një instrumenti borxhi të matur me kosto të amortizuar.</p> <p>(b) rrezikun e këmbimit valutor ose të normës së interesit në një angazhim të përcaktuar apo të një transaksioni parashikues me probabilitet të lartë.</p> <p>(c) rrezikun e çmimit të një malli që mbahet, ose në një angazhim të përcaktuar ose transaksion parashikues me probabilitet të lartë për të blerë ose shitur një mall.</p> <p>(d) rrezikun e këmbimit të monedhave të huaja në një investim neto në një operacion të huaj.</p>
66	<p>Rreziku i këmbimit të monedhave të huaja për një instrument borxhi të matur me kosto të amortizuar nuk është në listën e mësipërme të kontabilitetit mbrojtës, sepse nuk do të kishte ndonjë efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare. Instrumentet financiare bazë, dëftesat e borxhit dhe huatë e arkëtueshme / të pagueshme zakonisht maten me kosto të amortizuar (shih paragrafin 5 (d)). Kjo do të përfshijë detyrimet e përcaktuara në një monedhë të huaj. Paragrafi 15 në SKK 12 <i>Efektet e ndryshimeve të kurseve të këmbimit</i> kërkon që çdo ndryshim në vlerën kontabël neto të llogarisë së pagueshme për shkak të një ndryshimi në kursin e këmbimit të njihet në fitim ose në humbje. Prandaj, si ndryshimi në vlerën e drejtë të instrumentit mbrojtës (kontrata e ndër-shkëmbimit të monedhave) dhe ndryshimi në vlerën kontabël neto të llogarive të pagueshme në lidhje me ndryshimin e kursit të këmbimit, do të njihen në fitim ose humbje dhe duhet të kompensojnë njëri-tjetrin, përveçse deri në masën e diferencës midis normës së çastit (në të cilën detyrimi është i matur) dhe normës së ardhshme (në të cilën është matur kontrata e shkëmbimit).</p>
67	<p>Ky seksion lejon kontabilitetin mbrojtës vetëm në qoftë se instrumenti mbrojtës plotëson të gjitha termat dhe kushtet në vijim:</p> <p>a) është një kontratë për norma interesi swap, një kontratë swap e këmbimit të monedhave të huaja, një kontratë e ardhshme këmbimi e monedhave të huaja, ose një kontratë e ardhshme këmbimi të mallrave që pritet të jetë shumë efektive në kompensimin e një rreziku të identifikuar në paragrafin 64 që është përcaktuar si rrezik i mbrojtur ;</p> <p>(b) përfshin një palë të jashtme në lidhje me njësinë raportuese (d.m.th., e jashtme me grupin, segmentin apo njësinë ekonomike të veçantë për të cilën raportohet) ;</p> <p>(c) shumën e imagjinuar e tij është e barabartë me shumën e caktuar të principalit apo shumën e imagjinuar të zërit të mbrojtur ;</p> <p>(d) ka një datë të caktuar maturimi jo më vonë se:</p> <ol style="list-style-type: none"> (i) maturimi i instrumentit financiar të mbrojtur ; (ii) shlyerja e pritur e angazhimit në blerjen ose shitjen e mallrave ; apo (iii) ndodhja e transaksionit parashikues me probabilitet të lartë të monedhës së huaj ose të mallit që është i mbrojtur. <p>(e) nuk ka parapagim, ndërprerje të hershme ose zgjerim të karakteristikave.</p>
<p>Mbrojtja e rrezikut të normës fikse të interesit të një instrumenti financiar të njohur ose rrezikut të çmimit të një malli të mbajtur</p>	
68	<p>Në qoftë se kushtet e dhëna në paragrafin 64 janë përmbushur dhe rreziku i mbrojtur është ekspozimi ndaj një rreziku në normën fikse të interesit të një instrumenti borxhi të matur me kosto të amortizuar, ose rrezikut të çmimit të një malli që mbahet, njësia ekonomike do të:</p> <p>(a) njohë instrumentin mbrojtës si një aktiv ose detyrim dhe ndryshimin në vlerën e drejtë të instrumentit mbrojtës në fitim ose humbje; dhe</p> <p>(b) njohë ndryshimin në vlerën e drejtë të zërit të mbrojtur lidhur me rrezikun e mbrojtur, në fitim ose humbje dhe si një rregullim të vlerës kontabël neto të zërit të mbrojtur.</p>
69	<p>Nëse rreziku i mbrojtur është rreziku i normës fikse të interesit të një instrumenti borxhi të matur me kosto të amortizuar, njësia ekonomike do të njohë shlyerjet periodike neto në para të kontratës së këmbimit të normave të interesit, që është instrument mbrojtës, në fitim ose humbje në periudhën në të cilën shlyerjet neto konstatohen.</p>
70	<p>Njësia ekonomike do të ndërpresë kontabilitetin mbrojtës të specifikuar në paragrafin 68 nëse:</p> <p>(a) instrumentit mbrojtës i ka mbaruar afati ose është shitur ose ndërprerë;</p> <p>(b) mbrojtja nuk i plotëson kushtet për kontabilitetin mbrojtës, të specifikuar në paragrafin 64; ose</p>

	(c) njësia ekonomike heq dorë nga përcaktimi.
71	Nëse kontabiliteti mbrojtës është ndërprerë dhe zëri i mbrojtur është një aktiv ose detyrim me kosto të amortizuar që nuk është çregjistruar, çdo fitim apo humbje e njohur si rregullim i vlerës kontabël neto të zërit të mbrojtur amortizohet në fitim ose humbje duke përdorur metodën efektive të interesit mbi jetën e mbetur të instrumentit të mbrojtur.
	Mbrojtja e rrezikut të normës variabël të interesit të një instrumenti financiar të njohur, rrezikut të këmbimit të monedhave të huaja, ose rrezikut të çmimit të mallrave në një angazhim të përcaktuar apo transaksion parashikues me probabilitet të lartë, ose një investimi neto në një operacion të huaj
72	Në qoftë se kushtet e dhëna në paragrafin 64 janë përmbushur dhe rreziku i mbrojtur është: (a) rrezik i normës variabël të interesit të një instrumenti borxhi të matur me kosto të amortizuar, (b) rrezik i këmbimit të monedhave të huaja në një angazhim të përcaktuar apo i një transaksioni parashikues me probabilitet të lartë; (c) rrezik i çmimit të mallrave në një angazhim të përcaktuar ose i transaksionit parashikues me probabilitet të lartë; ose (d) rrezik i këmbimit të monedhave të huaja në një investim neto në një operacion të huaj; atëherë njësia ekonomike do të njohë në të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse pjesën e ndryshimit në vlerën e drejtë të instrumentit mbrojtës që ishte efektive në kompensimin e ndryshimit në vlerën e drejtë ose të rrjedhjeve monetare të pritshme të zërit të mbrojtur. Njësia ekonomike do të njohë në fitim ose në humbje çdo tejkalim të vlerës së drejtë të instrumentit mbrojtës mbi ndryshimin në vlerën e drejtë të rrjedhjeve monetare të pritshme (i quajtur nganjëherë joefektivitet i mbrojtjes). Fitimi ose humbja e mbrojtjes, e njohur në të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse do të riklasifikohet në fitim ose humbje kur zëri i mbrojtur njihet në fitim ose humbje, ose kur përfundon marrëdhënia mbrojtëse.
73	Nëse rreziku i mbrojtur është rreziku i normës variabël të interesit në një instrument borxhi të matur me koston e amortizuar, njësia ekonomike më pas do të njohë në fitim ose në humbje shlyerjet neto periodike në para të normave të interesit të kontratës swap që është instrument mbrojtës në periudhën në të cilën konstatohen shlyerjet neto.
74	Njësia ekonomike do të ndërpresë kontabilitetin mbrojtës të specifikuar në paragrafin 72 nëse: (a) instrumentit mbrojtës i ka mbaruar afati ose është shitur apo ndërprerë; (b) mbrojtja nuk i plotëson kushtet për kontabilitetin mbrojtës, të specifikuara në paragrafin 64; (c) në një mbrojtje të një transaksioni parashikues me probabilitet të lartë, transaksioni parashikues nuk është më me probabilitet të lartë; ose (d) njësia ekonomike heq dorë nga ky klasifikim (përcaktim). Nëse transaksioni parashikues nuk pritet të ndodhë apo nëse instrumenti i borxhit i mbrojtur i matur me koston e amortizuar është çregjistruar, çdo fitim ose humbje e instrumentit mbrojtës që është njohur në të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse, do të riklasifikohet nga të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse në fitim ose humbje.
	SHËNIMET SHPJEGUESE PËR INSTRUMENTET E TJERA FINANCIARE
75	Një njësi ekonomike duke zbatuar këtë seksion do të japë të gjitha informacionet shpjeguese të kërkuara në seksionin 1 duke përfshirë në këto shpjegime instrumentet financiare që janë brenda objektit të këtij seksioni, si dhe ato që janë brenda objektit të seksionit 1. Përveç kësaj, në qoftë se njësia ekonomike përdor kontabilitetin mbrojtës, ajo do të japë informacione shpjeguese shtesë sipas paragrafëve 76-78.
76	Një njësi ekonomike duhet të japë informacionin shpjegues në vijim veçmas për secilin prej katër llojeve të rreziqeve të përshkruara në paragrafin 65: (a) një përshkrim të mbrojtjes; (b) një përshkrim të instrumenteve financiare të përcaktuara si instrumente mbrojtës dhe vlerat e tyre të drejta në datën e raportimit; (c) natyrën e rreziqeve që mbrohen, duke përfshirë një përshkrim të zërit të mbrojtur.
77	Nëse një njësi ekonomike përdor kontabilitetin mbrojtës për një mbrojtje ndaj rrezikut të normës fikse të interesit ose rrezikut të çmimit për një mall të mbajtur (paragrafët 72-74) ajo do të japë informacionin shpjegues në vijim: (a) shumën e ndryshimit në vlerën e drejtë të instrumentit mbrojtës të njohur në fitim ose humbje; (b) shumën e ndryshimit në vlerën e drejtë të instrumentit të mbrojtur të njohur në fitim ose humbje.
78	Nëse një njësi ekonomike përdor kontabilitetin mbrojtës për një mbrojtje të rrezikut të normës variabël të interesit, rrezikut të këmbimit të monedhave të huaja, rrezikut të çmimit të mallrave në një angazhim të përcaktuar apo transaksion parashikues me probabilitet të lartë, ose të një investimi neto në një operacion të huaj

	(paragrafet 72-74), ajo do të japë informacion shpjegues për sa vijon: (a) periudhat kur pritet të ndodhin rrjedhjet e mjeteve monetare dhe kur ato pritet të ndikojnë në fitim ose humbje; (b) një përshkrim të çdo transaksioni parashikues për të cilin ishte përdorur më parë kontabiliteti mbrojtës, por i cili nuk pritet më të ndodhë; (c) madhësinë e ndryshimit në vlerën e drejtë të instrumentit mbrojtës që është njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse gjatë periudhës (paragrafi 72); (d) shumën që riklasifikohet nga të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në fitim apo humbje për periudhën (paragrafet 72-74); (e) madhësinë e çdo tejkalimi të vlerës së drejtë të instrumentit mbrojtës mbi ndryshimin në vlerën e drejtë të rrjedhave të pritshme të mjeteve monetare që është njohur në fitim ose humbje (paragrafi 68).	
	PARAQITJA E INSTRUMENTEVE FINANCIARE NË PASQYRAT FINANCIARE	
79	Aktivet / detyrimet financiare dhe të ardhurat / shpenzimet e lidhura me to do të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e performancës, në përputhje me kërkesat e SKK 2 <i>Paraqitja e pasqyrave financiare</i> .	
	DATA E HYRJES NË ZBATIM	
80	SKK 3 <i>Instrumentet financiare</i> , përditësuar në vitin 2023, do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël që fillojnë më ose pas datës 01.01.2025. Kërkesat e SKK 3 (2023) do të zbatohen në perspektivë.	
	TABELA KRAHASUESE	
81	Tabela më poshtë tregon se si korrespondojnë paragrafët e këtij Standardi me SNRF për NVM (2015). Paragrafët janë konsideruar si korresponduese nëse ato trajtojnë në përgjithësi të njëjtën çështje pavarësisht nga fakti që seksionet e referuara mund të kenë ndryshime.	
	Paragrafët e SKK 3	Paragrafët e SNRF për NVM botuar në korrik 2015
	Paragrafi 1	Sek 11.1
	Paragrafi 2	Asnjë
	Paragrafi 3	Asnjë
	Paragrafi 4	Sek 11.8
	Paragrafi 5	Sek 11.5
	Paragrafi 6	Sek 11.7
	Paragrafi 7	Sek 11.9
	Paragrafi 8	Sek 11.10
	Paragrafi 9	Sek 11.11
	Paragrafi 10	Sek 11.3
	Paragrafi 11	Sek 11.12
	Paragrafi 12	Sek 11.13
	Paragrafi 13	Sek 11.13
	Paragrafi 14	Sek 11.13
	Paragrafi 15	Sek 11.14
	Paragrafi 16	Sek 11.15
	Paragrafi 17	Sek 11.16
	Paragrafi 18	Sek 11.17
	Paragrafi 19	Sek 11.18
	Paragrafi 20	Sek 11.19
	Paragrafi 21	Sek 11.20
	Paragrafi 22	Sek 11.21
	Paragrafi 23	Sek 11.22
	Paragrafi 24	Sek 11.23

Paragrafi 25	Sek 11.24
Paragrafi 26	Sek 11.25
Paragrafi 27	Sek 11.26
Paragrafi 28	Sek 11.33
Paragrafi 29	Sek 11.34
Paragrafi 30	Sek 11.35
Paragrafi 31	Asnjë
Paragrafi 32	Asnjë
Paragrafi 33	Sek 11.36
Paragrafi 34	Sek 11.37
Paragrafi 35	Sek 11.38
Paragrafi 36	Sek 11.40
Paragrafi 37	Sek 11.41
Paragrafi 38	Sek 11.42
Paragrafi 39	Sek 11.45
Paragrafi 40	Sek 11.46
Paragrafi 41	Sek 11.47
Paragrafi 42	Sek 11.48
Paragrafi 43	Sek 12.1
Paragrafi 44	Asnjë
Paragrafi 45	Sek 12.3
Paragrafi 46	Sek 12.4
Paragrafi 47	Sek 12.5
Paragrafi 48	Sek 12.6
Paragrafi 49	Sek 12.7
Paragrafi 50	Sek 12.8
Paragrafi 51	Sek 12.9
Paragrafi 52	Sek 11.27
Paragrafi 53	Sek 11.28
Paragrafi 54	Sek 11.29
Paragrafi 55	Sek 11.30
Paragrafi 56	Sek 11.31
Paragrafi 57	Sek 11.32
Paragrafi 58	Sek 12.10
Paragrafi 59	Sek 12.11
Paragrafi 60	Sek 12.12
Paragrafi 61	Sek 12.13
Paragrafi 62	Sek 12.14
Paragrafi 63	Sek 12.15
Paragrafi 64	Sek 12.16
Paragrafi 65	Sek 12.17

Paragrafi 66	Sek 12.17
Paragrafi 67	Sek 12.18
Paragrafi 68	Sek 12.19
Paragrafi 69	Sek 12.20
Paragrafi 70	Sek 12.21
Paragrafi 71	Sek 12.22
Paragrafi 72	Sek 12.23
Paragrafi 73	Sek 12.24
Paragrafi 74	Sek 12.25
Paragrafi 75	Sek 12.26
Paragrafi 76	Sek 12.27
Paragrafi 77	Sek 12.28
Paragrafi 78	Sek 12.29
Paragrafi 79	Asnjë
Paragrafi 80	Asnjë
Paragrafi 81	Asnjë